

**AKT THEMELIMI I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“EKO-VEPRA” SH.P.K.**

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, person juridik, me NIPT J62221009S regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr. 2498 date 19.03.2009, me Seli Rruga e “Kavajës”, Nr.151, Tiranë, përfaqësuar nga Kryehirësia e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Anastasios Yannoulatos, lindur më 4 nëntor 1929, shtetas grek, mbajtës i pasaportës me nr. XE5075915, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, sot, më 10.10.2024, në mbështetje të legjislacionit shqiptar, respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” (i ndryshuar), ka vendosur të krijojë shoqërinë tregtare “EKO-VEPRA” SH.P.K., me një ortak të vetëm.

**NENI 1- EMRI DHE ADRESA**

Shoqëria emërtohet “EKO-VEPRA” Sh.p.k.

Selia e kësaj shoqërie gjendet në adresën: Rruga e “Kavajës”, Nr.151, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Transferimi i selisë së shoqërisë në një adresë tjetër, bëhet me vendim të ortakut të vetëm, i cili u njoftohet 10 ditë më parë të gjithë personave që kanë lidhje me të.

Adresa e shoqërisë për qëllimin e komunikimit elektronik është si vijon:

-Tel: 069 207 75 69

-Email: ekovepra@gmail.com

**NENI 2- FORMA E SHOQËRISË**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, “EKO-VEPRA” është person juridik që vepron sipas legjislacionit shqiptar, të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të shoqërisë, që është pjesë përbërëse e saj. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**NENI 3- KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare “EKO-VEPRA” Sh.p.k është e pakufizuar.



#### **NENI 4- OBJEKTI**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “EKO-VEPRA” Sh.p.k., do të ketë objekt të veprimtarisë të saj administrimin e të ardhurave neto që do të realizohen nga Veprat Hidroenergjitike Rapuni 3 & 4, si dhe cdo lloj aktiviteti ekonomik dhe social që është në përputhje me ligjin dhe me kushtet e këtij Statuti, të ardhura këto që do t’i transferohen Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

#### **NENI 5- KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lekë. Ai zotërohet nga Ortaku i Vetëm, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë.

Për të zmadhuar apo zvogëluar kapitalin themeltar të shoqërisë, Ortaku i Vetëm duhet të marrë vendim, i cili mbahet ne dokumentat e shoqërisë.

#### **NENI 6- TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i patrasferueshëm.

#### **NENI 7- VEPRIMTARIA EKONOMIKE**

-Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe rezultatet e saj ekonomike i pasqyron në bilancet e saj vjetore. Në kryerjen e kësaj veprimtarie zbaton ligjin “Për kontabilitetin”, që është në fuqi.

-Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

-Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

-Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

-Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

-Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtën e disponimit sipas qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria mbron pasuritë e saj sipas legjislacionit shqiptar

#### **NENI 8- ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- a) Ortaku i Vetëm,
- b) Administratori,



Mënyra e krijimit dhe funksionet e tyre përcaktohet në Statutin e shoqërisë.

Ortaku i shoqërisë është:

• Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë mbajtës i një kuote me vlerë 100,000 Lekë, e cila përfaqëson 100% te kapitalit

Ortaku i vetëm, është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë “EKO-VEPRA” Sh.p.k.

### **NENI 9- ADMINISTRATORI**

Shoqëria do të administrohet nga Z. Harallambe Gjoka, lindur në Himarë, më 24.07.1983, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. I30724042M, i cili do e ushtrojë këtë të detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjecare, me të drejtë riemërimi.

### **NENI 10- KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

- Administratori i ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj.
- Administratorit të vetëm i takon firma e lirë dhe përfaqësimi i Shoqërisë ndaj të tretëve në veprime, procedura dhe seanca gjyqësore ose administrative, si dhe pajtime e kompromise.
- Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.
- Administratori është kompetent të miratojë planet e llogarive ekonomike.
- Administratori është kompetent të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- Administratori është kompetent të përzgjedhë ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit.
- Administratori është kompetent në përcaktimin e numrit të punonjësve të Shoqërisë dhe pagave të tyre.

### **NENI 11- LARGIMI I ADMINISTRATORIT**

Administratori largohet nga detyra nëse:

- Pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i ndryshuar), përfshirë nenin 95 paragrafi 6.
- Vuan ose mund të vuajë nga crregullime mendore.
- Jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën Shoqërisë.





-Ka munguar për më shumë se tre muaj rradhazi pa leje në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

## **NENI 12- SHPËRBLIMI I PUNËS, PËRFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATORIT**

Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të Ortakut të Vetëm, të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (i ndryshuar).

## **NENI 13- KONFLIKTI I INTERESIT**

Administratori nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr asnjë vendim për asnjë çështje në të cilën ka, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, një interes të dytë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (i ndryshuar) nëse me vendim të Ortakut të Vetëm nuk është rënë dakord:

-të autorizojë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,

-të autorizojë të vendosë për çështjen në fjalë.

## **NENI 14- BILANCET**

Pasuria e shoqërisë pasqyrohet në bilancin e saj me vlerë të shprehur në monedhë shqiptare dhe po të shihet e nevojshme nga Ortaku i Vetëm, mbahet edhe në monedhë të huaj. Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike përcaktohet duke zbatuar legjislacionin shqiptar. Cdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Llogaritë vjetore, inventari, raportet për operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të përgatitura nga administratori apo eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja (Ortaku i Vetëm).

Të ardhurat neto të Shoqërisë që rezultojnë nga bilanci do të shpërndahen si vijon: 5% për fondin rezervë, derisa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar, pjesa tjetër i takon Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

## **NENI 15- KONTROLLI I SHOQËRISË**

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare me mundësi riemërimi. Ai caktohet nga Ortaku i Vetëm. Eksperti Kontabël i autorizuar garanton që llogaritë vjetore të shoqërisë janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar si dhe dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Verifikon librat e llogarisë si dhe fondet e shoqërisë, kontrollon përshtatjen e kontabilitetit me ligjin në fuqi, verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacionit të dhënë në raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarisë, dokumentat kontabël dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund të aktivizojë



ekspertë dhe bashkëpunëtorë për të përballuar volumin e punës, por me miratimin e Ortakut të Vetëm.

#### **NENI 16- MARRËDHËNIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me kontratat kolektive dhe ato individuale të cilat në emër të shoqërisë nënshkruhen nga administratori. Në të gjithë rastet zbatohet legjislacioni shqiptar që rregullon marrëdhëniet e punës.

#### **NENI 17- PRISHJA**

Shoqëria priset:

-Me vendim të Ortakut të Vetëm.

-Me hapjen e procedurave të falimentimit.

-Me vendim gjykate

-Nëse nuk ka kryer veprimtari në përputhje me pikën 3 të Nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, (i ndryshuar).

#### **NENI 18- LIKUIDIMI**

Likuidimi do të bëhet sipas normave të legjislacionit shqiptar. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit në momentin e prishjes së saj pavarësisht nga shkaqet. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaku i Vetëm, vendos 1 ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, ndjekjen e veprimtarisë së likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit, Asambleja (Ortaku i Vetëm) vendos mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuidimit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

*-Ky Akt-Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje në origjinal, në gjuhën shqipe, me fuqi të barabartë.*

**Ortaku i Vetëm**

**KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË**

**Përfaq. Nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë**

**Anastasios Yannoulatos**



*Anastasios Yannoulatos*